

Neni 52

Studenti ka të drejtë të ankohet për rezultatin përfundimtar të provimit. Ankesa i paraqitet me shkrim përgjegjësit të departamentit/seksionit/shërbimit brenda 48 orëve nga marrja dijani e rezultatit të provimit. Përgjegjësi i departamentit/seksionit/shërbimit bën verifikimet e duhura së bashku me komisionin e provimit dhe kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë menjëherë në dijeni dekanin/drejtorin. Dekani/drejtori, brenda 48 orësh nga marrja dijani për ankesën nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të dekanit/drejtorit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit.

Kur studentit nuk është dakord me vendimin e marrë nga departamenti, ka të drejtë të apelojë këtë vendim brenda 48 orëve nga njoftimi i tij në dekanatin përkatës.

Neni 53

Kriteret e kalimit në vitin pasardhës

Studenti kalon nga viti i parë në vitin e dytë, kur ka siguruar të paktën 30 kredite të vitit të parë.

Studenti kalon nga viti i dytë në vitin e tretë, kur ka siguruar të paktën 90 kredite nga viti i parë dhe i dytë.

Studenti kalon nga viti i tretë në vitin katërt, kur ka siguruar të paktën 150 kredite.

Studenti kalon nga viti i katërt në vitin e pestë, kur ka siguruar të paktën 210 kredite.

Studenti kalon nga viti i pestë në vitin e gjashtë, kur ka siguruar të paktën 270 kredite

Studneti mund te mbarte ne vitin pasardhes vetem kredite nga viti paraardhes i studimit.

Studenti nuk mund të hyjë në provim në lëndën e vitit pasardhës pa shlyer lëndët me kusht të viteve paraardhëse të përcaktuara në planin mësimor përkatës.

Kriteret e mësipërme aplikohen për studentët që fillojnë studimet në UMT në vitin akademik 2014-2015 e në vijim. Studentët që i kanë filluar studimet në UMT përpara këtij viti akademik i nënshtrohen kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i UMT.

Studenti lejohet të hyjë në mbrojtjen e diplomës, pasi ka fituar të gjitha kreditet e parashikuara në programin mësimor, dhe ka plotësuar të gjithë detyrimet e tjera që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi dhe rregulloret e fakulteteve përkatëse.